



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:272385

Datë: 18.04.2024

Numri i dokumentit: 05591271

Në ankesën e

AC-I-23-0255

Paditësi/Ankuesi

S I, të cilin e përfaqëson avokati B I, nga Prishtina.

Kundër

E paditura

NSH, "Pasuria Bujqësore"(në likuidim), të cilën e përfaqëson, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-1740 të datës 13 prill 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 18 prill 2024, me shumicë votash lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditësit është e bazuar.**
- 2. Ndryshohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-1740, i datës 13 prill 2023, dhe Vendimi i Autoritetit të Likuidimit GJI011-0179, i datës 11 tetor 2013.**
- 3. Obligohet AKP – Autoriteti i Likuidimit që në emër të kompensimit për ndërprerjen e parakohshme të kontratës së punës ti paguajë paditësit shumën prej 2,541.00 euro, interesin**

ligjor prej 10% në shumë prej 254.10 euro, si dhe shpenzimet e përfaqësimit nga ana e avokatit në shumë prej 208 euro, të cilat shuma do të paguhen sipas prioritetit të përcaktuar me ligj në procedurën e likuidimit.

4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 14 shtator 2015, përmes postës paditësi e dërgoi në DHPGJS-ë një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit GJI011-0179, të datës 11 tetor 2013, me të cilën kërkesa e paditësit e datës 09 korrik 2013 për kompensim për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës në shumë prej 2,541.00 euro, refuzohet si e pa vlefshme me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Në ankesë paditësi ka pohuar se me datë 22 qershor 2009, e ka pranuar njoftimin nga AKP-ja për ndërprerjen e marrëdhënies së punës si rezultat i privatizimit të NSH "Pasuria Bujqësore" dhe në këtë njoftim ai ka pohuar se është theksuar se punëtorët do të njoftohen lidhur me kërkesat për pagat e pa paguara pas fillimit të procedurës së likuidimit të NSH-së. Tutje ai pohon se ka bërë kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit me datë 09 korrik 2013, e cila pa ndonjë bazë është refuzuar kinse është parashkruar kërkesa. Paditësi në ankesë i referohet edhe disa rasteve nga jurisprudenca e Kolegjit të Apelit. Me ankesë paditësi po ashtu kërkon përveç borxhit kryesor edhe interesin ligjor.

Me datë 04 prill 2023, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS-ë mbrojtjen në ankesë në të cilën AKP-ja pohon se e mbështet qëndrimin e Autoritetit të Likuidimit, i cili ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. AKP-ja pohon se vendimi i ankimuar nuk bie ndesh me asnjë dispozitë ligjore të Ligjit të AKP-së, prandaj nuk ka bazë ligjore të shfuqizohet vendimi i ankimuar. Tutje AKP-ja pohon se NSH "Pasuria Bujqësore" është privatizuar me datë 22 qershor 2009, dhe të gjithë punëtorëve me këtë datë u është ndërprerë marrëdhënia e punës, prandaj punëtorët kërkesat për paga është dashur ti kërkojnë më së voni 3 vite nga data e ndërprerjes së marrëdhënies së punës. AKP-ja pohon se ajo nuk ka asnjë dëshmi se paditësi i ka kërkuar këto paga para ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent në afat prej 3 vitesh, andaj kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Bashkë me këtë parashtresë

AKP-ja ka dorëzuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit nga ana e paditësit, si dhe vendimin për formimin e anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 13 prill 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, me Aktgjykimin C-IV-15-1740, ankesën e paditësit e refuzoj si të pa bazuar, dhe e ka vërtetuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se paditësi ka kërkuar tek Autoriteti i Likuidimit kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, për shkak të privatizimit të NSH "Pasuria Bujqësore" me datë 19.06.2009, ndërsa kërkesën tek Autoriteti i Likuidimit e ka dorëzuar me datë 09.07.2013, që në bazë të nenit 376 paragrafi 1 i LMD-së, kjo kërkesë është parashkruar. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se paditësi nuk ka dorëzuar asnjë provë që do të vërtetonte se lidhur me kërkesën e tij ka paraqitur padi në afatin prej tri viteve në gjykatën kompetente. Andaj nga këto arsye me të drejtë Autoriteti i Likuidimit e kishte refuzuar kërkesën.

Me datë 05 maj 2023, paditësi përmes postës e dërgon një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-15-1740 të datës 13 prill 2023, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të aprovohet padia si e bazuar. Për më tepër në ankesë paditësi ka pohuar se atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës me datë 22 qershor 2009 si rezultat i privatizimit të NSH-së, dhe për këtë ai kishte pranuar njoftimin e AKP-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës. Tutje paditësi pohon se njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës me këtë ankesë ia dorëzoi gjykatës, që dëshmon se me veprimin e AKP-së si rezultat i privatizimit të NSH-së, atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës. Nga këto arsye paditësi thekson se në këtë rast nuk bëhet fjalë për parashkrim të kërkesës siç pretendon AKP-ja në vendimin e ankimuar, dhe siç ka konstatuar në mënyrë të gabuar Shkalla e I-rë e DHPGJS-së. Në ankesë paditësi i është referuar edhe disa rasteve nga jurisprudenca e Kolegjit të Apelit. Bashkë me ankesë paditësi ka bashkangjitur njoftimin e AKP-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 22 qershor 2009, kopjen e Librezës së punës e mbyllur 22 qershor 2009.

Me datë 03 korrik 2023, AKP-ja e dorëzon në DHPGJS një parashtresë dhe i përgjigjet ankesës së paditësit. Në këtë parashtresë AKP-ja e kundërshton ankesën e paditësit si të pabazuar dhe kërkon që të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i

Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i bazuar në ligj. Tutje AKP-ja ka pohuar se në mbrojtjen në padi ka sqaruar mjaftueshëm lidhur me argumentet e ngritura të ankesës dhe përsëritja e atyre argumenteve do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e të paditësit është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, pas provave të sjellura në Shkallën e II-të, më nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të ndryshohet.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit e datës 09 korrik 2013, e dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 2,541.00 euro nga NSH "Pasuria Bujqësore" (në likuidim) është refuzuar si e pa vlefshme me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Kolegji i Apelit vëren se edhe ankesa e paditësit e datës 14 shtator 2015, i referohet kërkesës për kompensim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij të dorëzuar në Shkallën e I-rë nuk kishte dorëzuar asnjë dëshmi për ta mbështetur kërkesën.

Bazuar në këtë gjendje faktike, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me të drejtë në mungesë të provave, ankesën e paditësit e kishte refuzuar si të pa bazuar, dhe e kishte vërtetuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij të dorëzuar në Shkallën e II-të ai ka bashkangjitur kopjen e njoftimit të AKP-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 22 qershor 2009, dhe kopjen e Librezës së Punës e mbyllur në të njëjtën datë. Këto prova në interes të drejtësisë dhe bazuar në nenin 70 të LDHP-së, pranohen në këtë fazë të procedurës nga Kolegji i Apelit. Me këto dy prova pa dyshim paditësi ka vërtetuar se me veprimin e AKP-së për shkak të privatizimit të NSH-së, atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës.

Andaj bazuar në këto dy prova paditësi ka të drejtë ti njihet kompensimi për ndërprerjen të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 2,541.00 euro, bazuar në përvojën e tij të punës më tepër se 25 vite në NSH, në bazë të nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Kolegji i Apelit vëren se AKP-ja në mbrojtjen në ankesë ankesën e paditësit e kundërshton vetëm për shkak të parashkrimit, ndërsa AKP-ja nuk ka ndonjë kundërshtim shprehimor lidhur me lartësinë e kërkuar të kompensimit. Andaj në bazë të këtij fakti, Kolegji i Apelit ia njih paditësit kompensimin në emër të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 2,541.00 euro, e cila do të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Kolegji i Apelit në rastet e mbyllura në jurisprudencën e tij, shumë herë ka konstatuar se Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës e ndërpre në afatin e parashkrimit. Prandaj nuk mund të mbështetet konstatimi i gabuar i Autoritetit të Likuidimit se kërkesa për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, është parashkruar.

Duke u bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, dhe në nenin 62.2 të LDHP-së, paditësit i njihet edhe e drejta në interes ligjor prej 10% në borxhin kryesor në shumë prej 254.10 euro, si dhe kompensimi i shpenzimeve të përfaqësimit nga ana e avokatit në shumë prej 208 euro, të cilat shuma po ashtu do të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Nga këto arsye, ankesa e paditësit është e bazuar, është ndryshuar Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, dhe është aprovuar padia si e bazuar.

Prandaj nga këto arsye, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore me datë 07 gusht 2023, për procedurën ankimore në shumë prej 20 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 18 prill 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
